



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Nr. ____ Prot

Tiranë, më ____2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data: 23.02.2020]

Për: **“SERVIS - AUTO 2000” SHPK**

Adresa: Rruga: Enriko Telini, Nd. 15, H. 1, Tiranë.

* * *

Procedura e prokurimit: **“Procedurë e hapur”- Shërbim** - Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me objekt: **“Riparim dhe mirëmbajtje automjete për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë”**, me fond limit: **13,000,000** (trembëdhjetë milion) Lekë (pa TVSH), me nr. **REF-82823-12-22-2020**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Riparim dhe mirëmbajtje automjete për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë”**, me fond limit: **13,000,000** (trembëdhjetë milion) Lekë (pa TVSH), me nr. **REF-82823-12-22-2020** dhe me afat kohor për ekzekutimin: Duke filluar nga data e lidhjes së kontratës/kontratave sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor, brenda afatit 24 (njëzet e katër) muaj të lidhjes së Marrëveshjes Kuadër.

Publikime të mëparshme (jo): Buletini i Njoftimeve Publike 28.12.2020, Nr.126.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët x

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

- | | |
|--|---|
| 1) “ALSTEZO” SHA
Emri i plotë i shoqërisë
Vlera: 8,373,800 (tetë milion e treqind e shtatëdhjetë e tre mijë e tetëqind) lekë (pa TVSH)
(me numra dhe fjalë) | J63208420N
numri i NIPT-it |
| 2) “POWER INDUSTRIES” SHPK
Emri i plotë i shoqërisë
Vlera: 9,424,650 (nëntë milion e katërqind e njëzet e katër mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë (pa TVSH)
(me numra dhe fjalë) | L51706022H
numri i NIPT-it |
| 3) “KADIU” SHA
Emri i plotë i shoqërisë | J61817045K
numri i NIPT-it |

Vlera: **11,422,048** (njëmbëdhjetë milion e katërqind e njëzet e dy mijë e dyzet e tetë) lekë (pa TVSH)
(me numra dhe fjalë)

- 4) **“SERVIS AUTO 2000” SHPK** **K31523078F**
Emri i plotë i shoqërisë **numri i NIPT-it**
Vlera: **8,823,500** (tetë milion e tetëqind e njëzet e tre mijë e pesëqind) lekë (pa TVSH)
(me numra dhe fjalë)

- 5) **“VILNIK MOTORS” SHPK** **L01314031G**
Emri i plotë i shoqërisë **numri i NIPT-it**
Vlera: **10,060,800** (dhjetë milion e gjashtëdhjetë mijë e tetëqind) lekë (pa TVSH)
(me numra dhe fjalë)

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

➤ **“VILNIK MOTORS” SHPK**

1. Arsyeja e skualifikimit për “VILNIK MOTORS” SHPK

- Nuk përmbush pikën 1 të seksionit 3.3 “Për kapacitetin teknik”, pasi në ditën e hapjes së ofertave nuk arriti të paraqesë dëshmi për shërbime të ngjashme të kryera gjatë 3 viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit. Vërtetimi dhe faturat e ngjashme të paraqitura nga operatori ekonomik, nuk janë në vlerën e kërkuar, pra janë në shumën më pak se 40% e vlerës së fondit limit (pa TVSH).

➤ **“ALSTEZO” SHA**

2. Arsyeja e skualifikimit për “ALSTEZO” SHA

- Nuk përmbush pikën 1 gërma a) të Kriterëve të Vecanta për Kualifikim, pasi ofertuesi nuk ka dorëzuar Formularin e Ofertës Ekonomike sipas shtojcës 1 të DST. Formulari i ofertës ekonomike i paraqitur nga operatori ekonomik në ditën e hapjes së ofertave, nuk përputhet me zërat e përcaktuar në shtojcën 1 “Formulari i ofertës ekonomike” të DST.
- Nuk përmbush pikën 2 të seksionit 2.3 “Për kapacitetin teknik”, pasi në ditën e hapjes së ofertave nuk arriti të provojë se ka të punësuar në stafin e tij teknik personelin teknik me profilet e punës të kërkuara në DST (motorrist, xhenerik, elektroaut, bojaxhi, saldator, gomist). Konkretisht, Operatori Ekonomik nuk i ka të deklaruar punonjësit në ListëPagesat e Punonjësve (E-Sig 025) për periudhën shtator 2020 – nëntor 2020, në profilet e kërkuara (motorrist, xhenerik, elektroaut, bojaxhi, saldator dhe gomist) sipas kodeve të punësimit të profesioneve të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar”.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomik të suksesshëm:

1) “SERVIS AUTO 2000” SHPK

Emri i plotë i shoqërisë

Vlera: **8,823,500** (tetë milion e tetëqind e njëzet e tre mijë e pesëqind) lekë (pa TVSH)
(me numra dhe fjalë)

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë organit qendror blerës Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, me adresë: Ministria e Brendshme, Sheshi Skënderbej, nr.3, Tiranë, Tel: 042247865, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi, për të lidhur marrëveshjen kuadër.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 29.01.2021;

Ankesa: Po

Kanë marrë përgjigje nga Organi Qendror Blerës në datë: 11.02.2021

TITULLARI I ORGANIT QENDROR BLERËS